

DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKO - ADMINISTRATIVE

Përgjegjëse e Departamentit

Dr. Doriana Pano

Aktivitetet shkencore që do të realizojmë në vitin akademik 2017 - 2018

Projekti për kërkimin shkencor dhe puna për të realizuar atë, për vitin akademik 2017 – 2018, do të organizohet ne këto drejtime;

- a) Aktivitete Shkencore ne formën e Konferencave Shkencore, Simpoziumeve, tavolinave të Punës etj.
- b) Punime shkencore individuale të stafit pedagogjik dhe botimet e realizuara nga ata ne nivel individual ne revista shkencore shqiptare dhe të huaja.
- c) Pjesëmarrje ne mënyrë të rregullt me artikuj ne botimet e revistës “Optime”, reviste shkencore e Universitetit tone, të paktën dy artikuj në vit nga pedagogët e këtij departamanti;
- d) Angazhim ne projekte të organizuar nga departamenti të stafit pedagogjik, të brendshëm apo të jashtëm.
- e) Kualifikim i vazhdueshëm i stafit akademik

Bashkëngjitur gjeni materialin më të detajuar mbi aktivitetet, (tab ka vetëm dy nga konferencat), që do realizojmë.

Data/Viti	Tema	Organizatoret	Vendi
22 Dhjetor 2017	Konferenca e 4-të ndërkombëtare “Problemet dhe sfidat e transformimit të shoqërisë shqiptare drejt standardeve të BE-së”	Albanian University” në bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universita’ Di Roma “La Sapienza”	Salla e Konferencave në “Albanian Univeristy”, Tiranë
Prill- Maj 2018	Konferenca studentore me temë “Sistemi i	Departamenti i Shkencave Politiko Administrative ne	Albanian University, Tiranë

	drejtësisë në Shqipëri, ndarja dhe kontrolli reciprok i pushteteve dhe Integrimim në BE”	bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Juridike	
--	---	--	--

Aktivitetet Shkencore

-Departamenti i Shkencave Politiko – Administrative, si një nga njësitë bazë të fakultetit të Shkencave Shoqërore, do të marrë pjesë edhe këtë vit në konferencën e 4rt Ndërkombëtare, **“Problemet dhe sfidat e transformimit të shoqërisë shqiptare drejt standarteve të Bashkimit European”** e organizuar nga “Albanian University” në bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universita’ Di Roma “La Sapienza”, që do i zhvillojë punimet pranë “Albanian University”, Salla e Konferencave, me **22 dhjetor 2017**. Qëllimi kryesor i kësaj konferenc është të sigurojë një qasje akademike dhe profesionale si dhe të nxisë diskutimin mbi zhvillimet e sotme më të rëndësishme si dhe përballja me problemet dhe sfidat e transformimit të shoqërisë drejt standarteve të Bashkimit European.

-Në muajin tetor përkatësisht në data 17, 18 tetor 2017, Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes në bashkëpunim me Zyrën e Sigurimit të Cilësisë organizoi trajnimin e pedagogëve të “Albanian University” në fushën e metodologjisë, të mësimdhënies dhe mësim nxënies si dhe zbatimit të ligjit të ri për arsimin e lartë. Në këto ditë trajnuese morën pjesë edhe pedagogët e departamentit të Shkencave Politiko-Administrative, ku mjaft interes pati referimi me temë **“Kurrikula e re në Arsimin e Lartë”**., nga Prof.dr. Nikoleta Mita.

-Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë në Universitetin “Fan. S. Noli” të Korçës në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Politiko-Administrative të Albanian Univeristy, do të marrin pjesë në projektin e përbashkët, për promovimin e Albumit studimor të ilustruar **“Vetëqeverimi i Korçës sipas të përkohshmeve "Adriatiku" dhe "Gazeta' e Korçës"” (Dhjetor 1916 – gusht 1918)** trajtesë dhe dokumente, me autore Prof. dr. Kaliopi Naska, pedagoge e brendëshme e departamentit të Shkencave Politiko-Administrative. (**nëntor 2017**)

Prill 2018, në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Juridike, organizohet për të dytën herë edhe këtë vit Konferenca studentore me temë **“Sistemi i drejtësisë në Shqipëri, ndarja dhe kontrolli reciprok i pushteteve dhe Integrimim në BE”**

-Departamenti i Shkencave Politiko – Administrative ka planifikuar realizimin, me studentet e Ciklit të parë të studimit Bachelor dhe studenteve të nivelit Master, në bashkëpunim me Qendrën e Studimit të Politikave Europiane për Zhvillimin Rajonal dhe Lokal (cdrls), një leksion të hapur në periudhën **maj 2018**, për të cilin jemi ende duke punuar për axhendën.

-Aktivitet i përbashkët i Bibliotekës Kombëtare me Departamentin e Shkencave Politiko - Administrative të Fakultetit të Shkencave Shoqërore në Albanian University. Leksion i hapur mbi mënyrat e kërkimit shkencor në Bibliotekën Kombëtare, në kuadër të përgatitjes të temave të kursit në lëndën Politikat në Ballkan. (**nëntor 2017- janar 2018**)

-Leksion studimor mbi Kodikët e Shqipërisë dhe vlerat historike që mbartin ato. Aktivitet i përbashkët me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave. Njohja e studentëve me këto vlera të mëdha të periudhës Bizantine të cilat ruhen në Arkivin Qëndror të Shtetit. (**nëntor 2017 - janar 2018**)

-Në kuadër të njohjes së politikave të ndjekura dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative organizon në bashkëpunim me Drejtorinë e Vendeve të Rajonit dhe të Vendeve fqinje në Ministrinë e Jashtme në Tiranë, veprimtarinë informuese me studentët e të dy cikleve të studimit (**Janar 2018**)

-Një projekt tjetër i rëndësishëm është dhe realizimi i një newsletter nga Departamenti ynë në format elektronik, pa kosto, e drejtuar nga Departamenti ynë, me nje bord prej të themi 3 pedagogësh dhe 3 studentësh, i cili mundet të ndahet në tre ose katër kapituj. Ky neësletter do të informojë në mënyre të drejtperdrejte dhe shkurt mbi reformat qe po ndodhin në vendin tonë, por jo vetëm, reformat administrative, territoriale etj. Mundet te krijoje lidhje direkte me linkes te Ministrive te ndryshme dhe Institucioneve te pavarura, buletineve, të bëjë një prezantim të Projekteve që aplikohen në Shqipëri, kuriozitetete, njoftime te aktiviteteteve ku mundet të jenë të interesuar edhe vetë studentet e departamentit, etj.

Studentet vetë do të jene ata qe do ta furnizojnë me informacion buletinin javor duke bërë kërkimet e tyre në lajme, gazeta, webside zyrtare etj.

Ky newsletter nuk ka kosto, menaxhohet lehtë nga Departamenti dhe përfshin shumë studentë në të. Eshte teper praktik, modern si koncept dhe gjithë përfshirës. Eshte edhe nje rekalmë e bukur e Departamentit tonë.

Organizimi i takimeve/ leksioneve të hapura është kthyer në një traditë të për departamentin tonë. Edhe këtë vit akademik ashtu si çdo vit tjetër departamenti do të organizoj leksione të hapura duke ftuar në auditoret tona studiues së politikave kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këto takime do të trajtohen problematikat ne lidhje me ceshtjet më delikate të vendit, pikëpamjet e tyre, etj. Emrat që parashikohen të jenë pjesëmarrës në orët e hapura, si dhe koha e realizimit do të jenë:

-Me datë **10 Dhjetor 2017**, ditë kjo që mbarë botën shënohet si “**Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut**”, si një përkujtim i përvitshëm i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, e cila u miratua në 10 dhjetor të vitit 1948 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, departamenti I Shkencave Politiko-Administrative do të organizojë një tryezë të rrumbullakët, ku të ftuar do të jenë, Avokati I Popullit,(emri), Kryetare e Autoritetit për Informim mbi dosjet e Ish-Sigurimit znj. Gentiana Sulaj dhe politologu e njeherazi pedagog I departamentit, z. Afrim Krasniqi.

-Mars 2018 në bashkëpunim me Institutin e Studimeve Politike, do organizohet një leksion i hapur me studentët e Fakultetit të Shkencave Shoqërore ku si temë do trajtohet: “ **Votimi i emigrantëve shqiptarë**” . Kjo është një nga çështjet që ka kohë që diskutohet nga politika shqiptare., ndaj dhe zgjodhëm ta trajtojmë edhe në aulat e Fakultetit të Shkencave Shoqërore.

Gjithashtu nuk duhet lene pa përmendur dhe një angazhim i mundshëm ne projektin Erasmus plus, projekt ky që do të mundësojë shkëmbimin e studentëve tanë me studentë të Universiteteve prestigjioze evropiane. Ajo do të përmiresojë performancën e studentëve, por njëkohësisht do të shërbejë dhe si esperience për universitetin tonë ne mënyrë qe të përmiresohet cilesia dhe niveli i mësimdhënies.